

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat dytësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e dytë të vitit 2024:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 216 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 864 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 395 milionë euro, në rritje vjetore me 4%;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 268 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.4 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, *bilanci i përgjithshëm i pagesave* rezultoi negativ, në rënie të mjeteve të rezervës valutore, rreth 117 milionë euro.

Deficiti i *llogarisë korrente* shënon 216 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 17 milionë euro (ose 8%), në sfondin e zgjerimit të suficitit tregtar në shërbime.

Suficiti tregtar në *shërbime* u zgjerua ndjeshëm në kategoritë *shërbime udhëtimi*, *shërbime transporti* dhe *shërbime biznesi*. Këto zhvillime sëbashku me zgjerimin e të *ardhurave dytësore* dhe ngushtimin e balancës negative të të *ardhurave parësore* ndikuan pozitivisht ecurinë e deficitit korrent, duke kompensuar thellimin e deficitit tregtar në *mallra*.


Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej 62 milionë euro, kundrejt fluksit neto pozitiv prej 119 milionë euro. Ky tremujor u karakterizua nga flukse të konsiderueshme dalëse të sektorit privat. Në të njëjtën periudhë një vit më parë, llogaria kapitale regjistroi flukse të larta hyrëse në formën e granteve drejt sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

*Shkalla e ekspozimit*² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në -277 milionë euro kundrejt nivelit prej -114 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Flukset hyrëse neto në *llogarinë kapitale dhe financiare* (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 147 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e deficitit korrent në masën 68%.

Në një total prej rreth 209 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e *investimeve direkte* (326 milionë euro) dhe të *investimeve të portofolit* (43 milionë euro), ndërkohë që *investimet e tjera* rezultuan në flukse neto dalëse, në rreth 160 milionë euro si pasojë e uljes së ekspozimit në huamarrje të ekonomisë shqiptare.

Rezerva valutore, në fund të qershorit 2024, shënon 5,518 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.4 muaj importe mesatare vjetore në *mallra dhe shërbime* dhe rreth 440% të *borxhit të jashtëm afatshkurtër*.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve). Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njësiteve rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.
2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.
3. Alokimi i SDR është një mënyrë për të plotësuar rezervat valutore të vendeve anëtare të Fondit, duke i lejuar anëtarët të zvogëlojnë varësinë e tyre në borxhin e brendshëm ose të jashtëm për ndërtimin e rezervave. Shqipëria ka përfutur nga alokimi i SDR nga viti 2009.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të dytë 2024, vëlimi i përgjithshëm i transaksioneve korrente u zgjerua me rreth 16% në terma vjetorë, në nivelin 5,926 milionë euro. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 216 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 17 milionë euro.

Përmirësimi *llogarisë korrente* u ndikua nga zgjerimi i suficitit në llogarinë e *shërbimeve*. Ky i fundit, së bashku me zgjerimin e balancës pozitive të të *ardhurave dytësore* dhe ngushtimin e balancës negative të të *ardhurave parësore* kompensuan plotësisht efektin negativ të përkeqësimit të bilancit tregtar në *mallra*.

Deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 135 milionë euro në terma vjetorë dhe reflekton kryesisht zgjerimin e importeve në grupmallrat “*mjete transporti*” dhe “*ushqime të përgatitura, pije alkolike, duhan*”, diktuar nga rritja e kërkesës së brendshme.

Në terma vjetorë, *suficiti tregtar në shërbime* u zgjerua me 14% në nivelin 864 milionë euro, ku *shërbimet e udhëtimit, të transportit dhe shërbimet e biznesit* zgjeruan ndjeshëm balancat e tyre pozitive.

Të ardhurat parësore (puna dhe kapitali) rezultojnë në balancë negative prej rreth -62 milionë euro, kundrejt -69 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. *Të ardhurat nga investimi (kthimit nga kapitali)* zgjeruan balancën negative me rreth 13 milionë euro, ndërkohë flukset neto hyrëse të të *ardhurave nga puna* janë rritur me +20 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 88% e shpenzimeve korrente⁴ kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore⁵ janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 61%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 31%).

Në tremujorin e dytë 2024, përmirësimi i deficitit korrent është ndikuar në masën më të madhe nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro						T2 2023	T2 2024
	T2 2023			T2 2024				
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi		
Llogaria korrente	2,352	9,253	11,605	461	11,145	11,605	233.0	215.5
<i>në përqindje ndaj PBB</i>	-12%	48%	60%	-2%	48%	50%		
Mallra	4,969	1,853	6,822	5,020	1,802	6,822	1,220	1,355
Shërbime	1,928	5,388	3,460	3,547	7,007	3,460	756	864
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerë	679	679	1	734	735	1	198	168
Transport	186	572	385	371	756	385	51	92
Udhëtime	696	3,263	2,567	2,001	4,568	2,567	388	473
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	60	178	119	100	219	119	19	28
Shërbime të tjera biznesi	358	494	136	442	578	136	93	125
Shërbime dhe mallra qeveritare	1	51	50	9	42	50	6	0
Shërbime të tjera	52	150	202	93	109	202	2	22
Të ardhura parësore	468	668	1,136	248	889	1,136	69	62
Të ardhura nga puna	458	493	35	582	617	35	131	151
Të ardhura nga investimet	925	167	1,092	830	262	1,092	201	215
Investime direkte	794	75	869	779	90	869	183	174
Investime portofoli	29	45	74	1	72	74	3	30
Investime të tjera	137	13	150	132	17	150	28	32
Mjetet e rezervës	34	34		83	83		12	22
Të ardhura të tjera parësore	1	8	9	0	9	9	1	1
Të ardhura dytësore	1,157	1,344	187	1,260	1,447	187	300	337
Të ardhura nga emigrantët	901	901	-	995	995	-	230	268

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (*shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve*)

⁴ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat parësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

⁵ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat parësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 13% në terma vjetorë, në nivelin 2,331 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 39% të transaksioneve korrente.

Eksporti i mallrave u rrit me 15% në terma vjetorë, në nivelin 488 milionë euro. Rritja më e madhe është vërejtur në eksportet e “produkteve minerale”.

Importi i mallrave është zgjeruar me 12% në terma vjetorë dhe shënon 1,843 milionë euro. Rritjen më të madhe e shënuan importet në grupmallrat “mjete transporti” dhe “ushqime të përgatitura, pije alkolike, duhan”.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,355 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë me 11%. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 26.5% nga 25.9% në një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Thellimi i deficitit tregtar në mallra reflektoi zgjerimin e kërkesës së brendshme për mallra ushqimorë dhe mjete transporti

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 864 milionë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 14%.

Vëllimi i transaksioneve tregtare në shërbime u rrit me rreth 18% në terma vjetorë. Kjo ecuri u diktua nga zgjerimi i vëllimit tregtar në shërbime udhëtimit dhe transporti, në reflektim të përmbushjes së ofertës turistike, përpos rritjes së konsiderueshme të numrit të vizitorëve të huaj në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, shërbimet e biznesit kanë vijuar zgjerimin e balancës pozitive.

Shërbimet e udhëtimit kanë zgjeruar balancën pozitive në +473 milionë euro, kundrejt nivelit +388 milionë euro, në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Të ardhurat dhe shpenzimet nga shërbimet e udhëtimit u rritën respektivisht me rreth 25% dhe 27%, në terma vjetorë, ku rritja e numrit të udhëtarëve ka qenë faktori përcaktues, por në të njëjtën kohë shpenzimi ditor është vlerësuar në rritje.

Gjatë tremujorit të dytë 2024, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 1,160 milionë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 688 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 67% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 79% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.



Shërbimet e transportit kanë zgjeruar balancën pozitive me rreth 41 milionë euro, në sfondin e zgjerimit të transportit ndërkombëtar të pasagjerëve.

Shërbime të tjera biznesi rezultuan me bilanc pozitiv prej 125 milionë euro, në rritje vjetore prej 35%. Për tremujorin e dytë të vitit, flukset valutore hyrëse për ekonominë shqiptarë nën këtë kategori shërbimi, shënuan rreth 149 milionë euro.

Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët⁶ u vlerësua në 168 milionë euro. Flukset valutore hyrëse të kësaj kategorie ranë në terma vjetorë me 15% në nivelin 168 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.

TË ARDHURAT PARËSORE


Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me balancë negative prej 62 milionë euro. Flukset hyrëse dhe dalëse, të kësaj kategorie të ardhurash, u rritën respektivisht me 30% dhe 19% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 151 milionë euro ose 15% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet në masën më të madhe rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet thelluan balancën negative, në nivelin 215 milionë euro, ose 7% më shumë kundrejt tremujorit të dytë të 2023. Investimet direkte mbizotërojnë, si instrument, flukset valutore neto nga investimi. Këtë tremujor, fluksi dalës neto në formën e fitimit të riinvestuar⁷ shënon 206 milionë euro nga 194 milionë euro në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënojnë 87 milionë euro (në rritje vjetore me 79%), prej të cilave 49 milionë euro janë interesa të paguara prej Qeverisë së Përgjithshme në kuadër të eurobondit.

Zgjerimi i të ardhurave nga puna ka përmirësuar balancën negative të të ardhurave parësore



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

⁶ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të dytë të huaj në vend.


⁷ Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri “fitim i riinvestuar”, si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave parësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.



TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 337 milionë euro. Rreth 79% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga “të ardhurat nga emigrantët”.

Prurjet valutore të emigrantëve, shënuan rreth 268 milionë euro, në rritje vjetore (17%). Gjatë periudhës, vijon rritja e dërgesave jo vetëm në kanale formale (sistem bankar dhe operatorë të transferimit të parave), por edhe në formën e prurjeve në cash.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

LLOGARIA KAPITALE

Për tremujorin e dytë të vitit, llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto dalës (negativ) prej 62 milionë euro, kundrejt fluksit neto hyrës (pozitiv) prej 119 milionë euro një vit më parë. Ky tremujor u karakterizua nga flukse të konsiderueshme dalëse të sektorit privat. Në të njëjtën periudhë një vit më parë, llogaria kapitale regjistroi flukse të larta hyrëse në formën e granteve drejt sektorit të Qeverisë së Përgjithshme.

LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në një fluks hyrës neto prej rreth 209 milionë euro, krahasimisht me fluksin hyrës prej 591 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2023, - periudhë e cila përkon me zgjerimin e detyrimeve si rezultat i emetimit të eurobondit të Qeverisë së Përgjithshme.

Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (prej rreth 326 milionë euro) dhe të investimeve të portofolit (prej rreth 43 milionë euro), ndërkohë që investimet e tjera rezultuan në fluks neto dalës (prej rreth 160 milionë euro).

Flukset hyrëse jo borxh krijuese në formën e investimeve të huaja direkte shënuan 378 milionë euro. Injektimi me kapital të ri shënoi 193 milionë euro, ose 4% më shumë se një vit më parë. Ndërkohë që, kategoria fitimi i riinvestuar, u ngushtua me 7 milionë euro, në nivelin 185 milionë euro. Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks hyrës prej 18 milionë euro (zgjerim i detyrimeve si instrument borxhi mes kompanive të lidhura).


Në total, për tremujorin e dytë të vitit, investimet e huaja direkte u vlerësuan në 395 milionë euro, me rritje rreth 4% në terma vjetorë.

Për tremujorin e dytë të vitit 2024, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 268 milionë euro




Gjatë tremujorit të dytë 2024, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 25%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 14%), e hidrokarbureve (në masën 13%), e energjitikës (në masën 13%), si dhe komunikacionit (në masën 4%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* regjistruan 69 milionë euro, në rënie vjetore prej 8%.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 395 milionë euro, me rritje rreth 4% në terma vjetorë


Investimet e portofolit rezultuan në një fluks neto hyrës prej 43 milionë euro. Sektori i Korporatave Depozituese ka ulur zotërimet jashtë në letra me vlerë të borxhit, në rreth 110 milionë euro. Në të njëjtën kohë, ka vijuar rënia e detyrimeve ndaj jorezidentëve, në drejtim të tkurrjes së ekspozimit të letrave me vlerë të borxhit me 72 milionë euro (si pasojë e rritjes së pjesëmarrjes së bankave rezidente në eurobondin e Qeverisë së Përgjithshme).

Llogaria investimet e tjera u mbyll në një fluks neto dalës prej 160 milionë euro, ku zhvillimet kryesore lidhen me sektorin e Korporatave Depozituese dhe të Qeverisë së Përgjithshme.

Sektori i Korporatave Depozituese ka zgjeruar portofolin e huadhënies ndaj sektorëve të tjerë jorezidentë, me rreth 57 milionë euro, si dhe në të njëjtën kohë ka ulur detyrimet afatshkurtra në huamarrje ndërbankare, me rreth 42 milionë euro.

Qeveria e Përgjithshme ka shlyer detyrimet në formën e huasë, në rreth 76 milionë euro.





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të dytë 2024, mjetet e rezervës ranë me 117 milionë euro, për efekt sëbashku, reduktimin e tepricave të sistemit bankar, dhe shlyerjeve të detyrimeve të Qeverisë së Përgjithshme.

Në fund të periudhës, rezerva valutore shënon 5,518 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 6.4 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

*Rezerva valutore
vlerësohet mjaftueshëm
për mbulimin e 6.4
muaj importe mesatare
vjetore në mallra e
shërbime*



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihë përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave, si pasojë e rishikimeve, pasojë e plotësimit të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.

Është rishikuar seria kohore T1/2023-T1/2024, bazuar në politikën e rishikimit të Bankës së Shqipërisë

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html